




REPUBLICA E KOSOVES - PUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. i raq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br Prot Prot No	03-02/4322/13
Data Datum Date	29.12.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2538/17, për zyrtarin e lartë z. Brahim Mehmetaj, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2538/17, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Brahim Mehmetaj, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Brahim Mehmetaj, figuron si person i autorizuar në bizneset private me emër "Syri Group" Sh.p.k, dhe N.SH "TV Bi Cabel TV" e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Mehmetaj, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka shprehë interes për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.



Ne këtë komunikim z.Mehmetaj, është njoftuar për situatën të cilën gjendet, ai ka deklaruar se procedurën për largimin e tij nga personi i autorizuar ne bizneset e përmendura e ka filluar me herët por ndoshta nuk është përfunduar ende, por është zotuar se do të veproj menjëherë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi.

Pas këtyre veprimeve, nga z.Brahim Mehmetaj, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z. Brahim Mehmetaj, nuk figuron me si person i autorizuar ne bizneset private me emër "Syri Group" Sh.p.k, dhe N.SH "TV Bi Cabel TV".

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga, z.Brahim Mehmetaj, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, duke bërë ndryshimet ne biznes, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar ne bizneset private janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havollari
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

